

PKR.nr. 201/17**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit D.P nga fshati D Komuna G, për shkak të veprës penale Asgjësimi i dokumenteve të votimit nga neni 220 par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.103/2017 të datës 11.06.2017, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 13.06.2017, me praninë e Prokurorit të shtetit Armend Hamiti, të pandehurit D.P, me mbrojtësen e caktuar sipas detyrës zyrtare av. F.H, dhe me interpreten e kësaj gjykate, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri D.P, i biri i F dhe nënës C, e vajzërisë J, i lindur me *data e lindjes* në fshatin D Komuna G ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, merr ndihmë gati 100 euro nga Republika e Serbisë, i martuar babë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Serb – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal *numer personal*, i ndaluar nga data 11.06.2017,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 11.06.2017 rreth orës 14:30, në Qendrën e Votimit me numër “3409E-02D”, në Shkollën Fillore “K LI” në fshatin D Komuna G, nën ndikimin e alkoholit prej 1.29 promila, duke shprehur kinse pakënaqësinë pse djalit të tij nuk iu ka lejuar votimi, ka ofenduar verbalisht anëtarët e komisionit zgjedhor dhe ka asgjësuar fletën e votimit të zgjedhjeve, duke shqyer atë,

- me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi i dokumenteve të votimit nga neni 220 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 41,42, 49, 50, 51, 73, 74, 75 par. 1 pika 1.3, 76 par. 1 pika 1.5 të KPRK dhe nenit 248, 365, 366 të KPP, i shqiptoi:

DËNIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) muajsh**, i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy) vitesh**, nuk do të kryejë veprë të re penale, si dhe

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, obligohet të paguajë shumën prej **30 (tridhjetë) euro** në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën të drejtpërdrejtë PP.I.nr.103/2017 të datës 11.06.2017, ka akuzuar D.P, për veprë penale Asgjësimi i dokumenteve të votimit nga neni 220 par.1 të KPRK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit, si dhe t'i caktojë masën e paraburgimit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 13.06.2017 në të cilin i pandehuri D.P, në prani të av. F.H, pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtën në gjuhën e tij amtare, i vënë në dijeni të plotë për natyrën, pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, me vullnet dhe vetëdije të plotë, e pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për çka sinqerisht kërkoi falje për shkak se siç ka theksuar i njëjti ka qenë në depresion për shkak të sëmundjes dhe ka qenë shumë i nervozuar, theksoi se ndihet i penduar, se kjo ka qenë hera e parë të ketë rënë ndesh me ligjin dhe premtoi se edhe në të ardhmen asnjëherë nuk do të përsëris veprë të tillë apo të ngjashme.

Mbrojtësja e të pandehurit, av. F.H e mbështeti pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj duke theksuar se i pandehuri pendohet për veprimin e tillë dhe asnjëherë në të ardhmen nuk do të kryej një veprë të tillë apo të ngjashme.

Pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit theksoi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që një pranim i tillë i është në përputhje me të gjitha provat e paraqitura, poashtu edhe vullneti i shprehur për pranimin fajësie është i njëjtë edhe me deklarinimin që e ka bërë gjatë hetimeve kur thotë se i vjen keq që e ka kryer këtë veprë, andaj i ka propozuar gjykatës që të pranojë fajësinë e të pandehurit pasi që kjo është në përputhje me provat edhe me dispozitat ligjore. Gjithashtu prokurori theksoi se duke pas parasysh tani rrethanën e krijuar kur i pandehuri pranoi fajësinë, dhe se tanimë nuk ka nevojë për asnjë seancë tjetër gjyqësore, e tërëhjeku propozimin që të njëjtit ti caktohet masa e paraburgimit.

Pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe të vullnetshme ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimi të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri D.P për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, meqë në veprimin e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Asgjësimi i dokumenteve të votimit nga neni 220 par. 1 të KPRK, pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, shprehjen dukshëm të sigurtë të keqardhjes për rastin e ndodhur, pendimin, gjendjen shëndetësore të tij kur i njëjti nuk mund të qëndronte në këmbë si dhe moshën e shtyer të tij, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj, të njëjtit i përcaktoi dënim të zbutur me burgim, të cilin ia kushtëzoi për periudhe të caktuar verifikuese, te precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të t'pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund dhe, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 201/17, me datë 13.06.2017**

**Sekretarja juridike,
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.